

**NJOFTIM  
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME  
TË AKSIONERËVE TË “BANKA CREDINS” SH.A.**

Për: Z/Znj. \_\_\_\_\_ (Aksionar/Përfaqësues/e i/aksionarit \_\_\_\_\_)

Ju njoftojmë se ditën e Marte datë 27 Maj 2025 ora 11:00 në ambientet e “ BANKA CREDINS” SH.A., në adresën Rr. “Vaso Pasha” Nr. 8, Tiranë, do te zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të “BANKA CREDINS” SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Mbi miratimin e Pasqyrave Financiare të shoqërisë “Bankës Credins” sha per vitin 2024 sipas IFRS.
2. Mbi miratimin e Pasqyrave Financiare të shoqërisë “Bankës Credins” sha per vitin 2024 sipas kërkesave te Bankes se Shqipërisë.
3. Mbi miratimin e Rezultatit Financiar te shoqërisë “Banka Credins” sipas IFRS dhe Bankës se Shqipërisë sh.a per vitin 2024.
4. Mbi miratimin e përdorimit te fitimit të shoqërisë “Bankës Credins” sha per vitin 2024.
5. Mbi miratimin e dhënies se bonusit per Drejtorinë ne masën 1% dhe per Keshillin Drejtues ne masen 0.5% te rezultatit financiar te vitit ushtrimor sipas BoA.
6. Mbi miratimin e ekspertes kontabël te autorizuar Znj.Vera Fazlli Lala per vlerësimin e zmadhimit te kapitalit aksioner te shoqërisë “Banka Credins” Sh.a nëpërmjet kalimit te fitimit te pashpërndare te vitit 2024.
7. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme te Jashtëzakonshme te Aksionareve te Shoqërisë Credins Invest sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive që do te zhvillohet me rend dite si me poshtë:
  1. Mbi miratimin e përzgjedhjes së shoqërisë audituese për auditimin e pasqyrave financiare të:
    - Shoqërisë Administruese “Credins Invest” sh.a.,
    - Fondit të Pensionit “Credins Pension”,
    - Fondit të Pensionit “Master Pension Fund”,
    - Fondit të Investimit “Credins Premium”,
    - Fondit të Investimit “Credins Dynamic”,
    - Fondit “Sea Land Alternative Investment Fund” Shoqëri Komandite SIK,
    - Fondit “Green View Alternative Investment Fund” Shoqëri Komandite SIK.
    - Fondit të Investimit Alternativ “Credins Optimal”.
    - Fondit të Investimit Alternativ “Credins Global Bonds”.për vitin financiar që mbyllet me 31.12.2025.

2. Mbi miratimin e tekstit të draft kontratës që do të lidhet me shoqërinë audituese.
3. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

**Maltin KORKUTI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**



Tiranë më 06.05.2025

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionarët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»
- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
  - a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;
  - b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».
- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.
- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.
- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.
- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.
- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.
- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Kopje të dokumenteve dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.